

Të nderuar arsimtarë,
Të dashur nxënës,
Të nderuar mysafirë,

Mirë se keni ardhë sot në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Jam shumë i nderuar që sot bashkë me ju po e shënojmë ditën botërore të kursimeve. Kjo ditë është një ditë shumë e rëndësishme për sistemin financiar dhe tashmë shënimi i saj është bërë një traditë në BQK. Kjo ditë e cila për herë të parë ishte shënuar në vitin 1924 në kongresin ndërkombëtar të bankave të kursimit në Milano të Italisë tani festohet në mbarë botën duke organizuar aktivitete të ndryshme të cilat kanë për qëllim të kultivojnë kulturën dhe të zhvillojnë shprehitë e kursimeve. Shprehitë dhe kulturën e kursimit fillojmë ta mësojmë që nga fëmijëria. Fraza më e shpeshtë të cilën e dëgjojmë qysh në moshën e hershme është një euro e kursyer është një euro e fituar. Kjo frazë tregon më së miri rëndësinë e kursimeve. Kursimet na ndihmojnë që të arrijmë ëndrrat dhe qëllimet tona. Lidhur me rëndësinë e kursimeve dëshiroj të citoj një nga investitorët më të suksesshëm Warren Buffet, i cili kishte thënë “mos kurse atë që mbetet pas shumës së shpenzuar, por shpenzo atë që mbetet pas shumës së kursyer”.

BQK-ja në kuadër të programit për edukim financiar ka organizuar garën për nxënësit e klasave 6-9 të shkollave fillore të Kosovës, që të marrin pjesë në konkursin e përzgjedhjes së esesë më të mirë rreth kursimit dhe financave me moton “Kursimet për një të ardhme më të mirë”. Kjo garë ishte shumë kreative, kishte shumë ese të mira dhe komisioni kishte punë shumë të vështirë në përzgjedhjen e fituesit. Unë mund të them se në këtë garë nuk kishte humbës. Të gjitha esetë ishin shumë të mira dhe kam nderin që sot të ndajë çmimet për më të dalluarit.

Me pjesëmarrjen tuaj në këtë garë ju e keni nderuar BQK-në dhe unë ju premtoj se do të jem pranë jush edhe në të ardhmen nëpërmjet organizimit të aktiviteteve tjera. Unë shpresoj që kjo garë ju ka ndihmuar që të kuptoni më mirë rëndësinë e financave dhe kursimeve dhe besoj që tashmë disa prej juve veç së kanë filluar të ëndërrojnë këtë profesion dhe në të ardhmen mund të jeni pjesë e BQK-së apo institucioneve tjera financiare.

Juve nxënës të dashur ju uroj të arrini rezultate të shkëlqyera në shkollë, gjë që besoj se do të jetë shumë e lehtë me ndihmën e arsimtarëve tuaj të shkëlqyeshëm.